



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT KORÇË

VENDIM

Nr. 11, dt. 30.10.2023

**MBI MIRATIMIN E PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM TË RISHIKUAR DHE
KËRKESAVE BUXHETORE 2024-2026 PËR KËSHILLIN E QARKUT**

Në mbështetje të Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 77, Ligjit Nr.9936, dt.26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Udhëzimit nr. 23 date 30.07.2018 “Për procedurat standarde të PBA të njësisve të vetëqeverisjes vendore”, Ligjit “Për buxhetin e vitit 2023”, Udhëzimit nr 7 datë 25.02.2022 “Për një ndryshim në Udhëzimin nr. 23 datë 30.07.2018, Udhëzimit nr. 6 datë 28.02.2023 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2024-2026”, udhëzimit plotësues nr.21 dt.07.07.2023 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2024-2026, vendor” Vendimit të Këshillit të Qarkut nr. 2 datë 17.03.2023 “Mbi miratimin e tavanëve përgatitore të PBA 2024-2026”, me propozim të Kryesisë, Këshilli i Qarkut Korçë

VENDOSI

1. Të miratojë dokumentin e rishikuar të Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026 si dhe kërkesat buxhetore 2024-2026 për Këshillin e Qarkut Korçë, të përgatitur sipas Instrumentit të Planifikimit Financiar.
2. Të miratojë relacionin shpjegues për procesin e përgatitjes së dokumentit të rishikuar të PBA 2024-2026.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Grupi i Menaxhimit Strategjik dhe Sektori i Financës, Zhvillimit Ekonomik, Shërbimeve, Burimeve Njerëzore dhe Zhvillimit të Territorit.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar i Këshillit të Qarkut

Erjon NEXHIPI

Konceptoi O. Beqiraj
Juristi Gj. Kristo
Sek. K. Qarkut B. Muço

